

# Asistenca shtëpiake



Përkujdesje ambulante  
Përkujdesje për të sëmurë  
dhe të moshuar  
Përkujdesje intensive  
Gjithçka rreth përkujdesjes  
Mirëmbajtje shtëpiake  
Shërbime në fqinjësi  
Përkujdesje në familje  
Informacione & Konsulencë

## Asistenca shtëpiake

- Bërja e pazarit
- Gatimi
- Pastrimi i banesës
- Larja e enëve
- Ndërrimi/larja/hekurosja e
- Ndërresave/veshjeve
- Përkujdesja/trajtimi i kafshëve shtëpiake

Asistenca shtëpiake është një pjesë e ndihmës dhe kujdesit në shtëpi. Ajo përfshinë ndihmën në punët që përsëriten rregullisht dhe më shpesh gjatë jetës së përditshme si pazari, gatimi, pastrimi i banesës, larja e enëve, ndërrimi dhe larja e çarçafëve dhe veshjeve apo dhe ngrohja e ambientit.

Shërbimet shtëpiake po kërkohen gjithnjë e më shumë në shoqërinë tonë!

Na kontaktoni – ne do t'ju vimë në ndihmë me kënaqësi!

## Koncepti ynë i përkujdesjes

- Konsulenca, bisedime dhe shoqërim individual i pacientëve dhe të afërmëve të tyre. Vendosja e kontaktit me klinikat dhe mjekët mbikqyrës.
- Negociim me institutin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për marrjen përsipër të shpenzimeve.
- Ndihmë në përcaktimin dhe organizimin e nevojës për ndihmë
- Evidentimi dhe organizimi i nevojës për përkujdesje dhe medikamente.
- Dhënia e ndihmës për parapërgatitjen e ambientit të shtëpisë, konsultim në vend
- Vënia në dispozicion e një skuadre të kualifikuar dhe me përvojë për përkujdesje.
- Mbështetje gjatë marrjes në dorëzim të pacientit nga: spitali, azili, bujtina, etj.
- Hartimi i planeve individuale të përkujdesjes
- Trajtimi dhe mbikqyrja e pacientëve sipas standarteve
- Udhëzime dhe ndihmesë për pjesëtarët e familjes së pacientit
- Dokumentim i detajuar dhe profesional i veprimtarive të kryera
- Negarantohet dhe zgjerohet kompetencat tona profesionale dhe si rrjedhojë edhe cilësinë e përkujdesjes nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme.
- Shoqërim dhe përkujdesje për të vdekurit dhe të afërmëve të tyre.

# Të dhëna kontakti

**IPD Intensiv-Pflege-Dienst**  
IPD( Shërbimi intensiv përkujdesjeje)

Adminstrator + Pronar  
Zoti Isa Elezaj


[www.intensiv-pflege-dienst.de](http://www.intensiv-pflege-dienst.de)  
E-mail: [isaelezaj@ipd-int-pflege.de](mailto:isaelezaj@ipd-int-pflege.de)

Adminstrata  
Zonja Sabine Digel  
Tel: 07471 / 62 08 96

**IPD Intensiv-Pflege-Dienst**  
Grabenäcker 10  
72411 Bodelshausen  
(afër Shtuttgart)  
Tel: 07471 / 62 08 96  
Faks: 07471 / 62 09 93  
Celular 24h: 0160 / 97 32 37 90

**IPD Intensiv-Pflege-Dienst**  
Am Markt 1  
21614 Buxtehude  
(afër Hamburg)  
Tel: 04161 / 5 58 98 55  
Celular 24h: 0160 / 97 32 37 90

# IPD



**Intensiv  
Përkujdesje  
Shërbim**

Asistenca shtëpiake

**Rreth Clock**  
në duart më të kualifikuar  
Motoja jonë: Mos shkoni – nuk ka

**24  
orë**

# KONCEPTET E PËRKUJDESJES

## Shërbimet bazë

Shërbimet nga institucioni i sigurimeve shëndetësore i përfitojnë vetëm ata, që kanë nevojë për ndihmë në fushën „**Shërbime bazë dhe përkujdesje shtëpiake**“.

Shërbimi bazë – përkujdesja për trupin shërben në rradhë të parë për rritjen e mirëqenies. Të ndihesh i freskët, i pastër dhe me aromë të mirë, të nxitë ndjesinë e të qenit i shëndetshëm. Prandaj ky është një aspekt i rëndësishëm tek personat e moshuar dhe tek ata që kanë nevojë për përkujdesje. Koha e shërbimeve bazë shfrytëzohet edhe për biseda, për mobilizim, për realizimin e ushtrimeve me lëvizje etj., dhe personi të cilit i shërbehet merr njëkohësisht edhe më shumë përkushtim dhe kontakt fizik.

- Larje të pjesshme – ose të tërë trupit
- Trajtimi aktivizues i trupit
- Larja dhe krehja e flokëve
- Trajtimi i syve, hundës dhe veshëve
- Trajtimi i gojës, dhëmbëve dhe protezave në dhëmbë
- Profilaksi ( pneumoni, dekubitus ...etj..)
- Dush ( edhe në shtrat, me sisteme të veçanta të dusheve)
- Veshja/Zhveshja
- Përgatitje e gatimeve të vogla

- Mobilizim/transferimi me mjete ndihmëse të veçanta, psh. Ashensor
- Trajnim i lëvizjeve: aktiv nëpërmjet gjimnastikës së të sëmurit pasiv me aparate terapie
- Organizimi i kohës së lirë duke marrë parasysh mundësitë organizative dhe logjistike. Kjo mundëson pjesëmarrjen në jetën e përditshme.
- Vendosje të veçanta
- Ndihmë gjatë urinimit

## Përkujdesja dhe trajtimi

Trajtimi dhe përkujdesja është një shërbim i ofruar nga sigurimet shëndetësore edhe paguhet po nga shërbimet shëndetësore.

## Më të rëndësishmet në një vështrim

Trajtimi përfshin shërbimet e rekomanduara nga mjeku, të cilat kryhen nga personeli përkujdesës në fushën e kujdesit për shëndetin tek pacientët apo edhe në azilet e të moshuarve. Në trajtim, krahas asistencës mjekësore përfshihen edhe përkujdesja për plagët, dhënia e medikamenteve, ndërrimi i fashove apo matja e tensionit. Kjo gjë dallohet dukshëm nga shërbimet bazë.

Mjeku familjar përcakton diagnozën dhe trajtimin. Nëse juve të nuk jeni në gjendje për të realizuar këtë trajtim, atëherë

mjeku që ju ka nën mbikqyrje, lëshon një **“recetë për trajtim shtëpiak të pacientit”**. Nëse nuk ka pjesëtar familjeje që ta marrë përsipër këtë përkujdesje, shërbimi Juaj shëndetësor merr përsipër shpenzimet për këtë shërbim.

- Organizimin dhe dhënien e medikamenteve sipas recetës së mjekut
- Bërja e shiringës (i.m./s.c./i.v.) sipas recetës së mjekut
- Organizimi dhe dhënia e ushqimit/ushqyerje me sondë
- Fashimi dhe përkujdesja për plagët (p.sh. PEG, tub trakeostemik, dekubitus...etj)
- Pastrimi (me thithje) oral, nazal dhe endotrakeal
- Kontrolli i vlerave vitale sipas rekomandimeve mjekësore (p.sh. tensioni i gjakut, pulsi ,temperatura, sheqeri në gjak, frekuenca e frymëmarrjes, SpO2+ pCO2, etj.)
  - Vënia e pomades sipas recetës mjekësore
  - Mobilizimi dhe pozicionimi: (psh: mekanizëm ngritjeje, dyshek me ajër të presuar,...)
  - Trajnimi i komunikimit: (p.sh. me tabela me ilustrime, kompjuter komunikues, ...)
  - Mbështetje dhe mbikqyrje gjatë kryerjes së nevojave personale
  - Dhënia e oksigjenit sipas urdhërit të mjekut.

- Përdorimi dhe trajtimi me aparatura mjekësore (p.sh. aparat frymëmarrjeje, njomës ajri aktiv, aparat përthithës, perfuzor,...)
- Ndërrimet e tubave trakeostomik sipas rekomandimeve mjekësore
- Vendosja dhe ndërrimi i kateterit urinar sipas rekomandimeve mjekësore
- Pastrimi /dhe trajtimi i fshikëzës urinare sipas rekomandimeve mjekësore
- Mbikqyrje dhe trajtim i veçantë nga mjekë specialistë dhe nga terapistë të frymëmarrjes.

## Përkujdesje me pengesa

Në kuadrin e „Përkujdesjes me pengesa“ (e quajtur edhe Përkujdesje zëvendësues) pjesëtarët e familjes që kanë persona nën kujdestari për përkujdesje, në raste pengesash (pushime, sëmundje etj.) mund të aplikojnë për përkujdesje shtëpiake tek shërbimi ynë i përkujdesjes.

